

Për:	Operatorë Ekonomik: TFS GROUP SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: **25.08.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **TFS GROUP SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **TFS GROUP SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **24.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **TFS GROUP SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **24.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **25.08.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI 1:

Ne konsiderojmë se ju si AK jeni në kundërshtim të plotë me Nenin 17 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime sepse në dosje të tenderit është kërkuar si më poshtë:

Kërkesa 3

c. Operatori Ekonomik obligohet që të punësoi minimum: 26 punëtorët nga Lista e Autoritetit Kontraktues dhe 6 punëtor shtesë nga lista e OE-së

Dëshmia 3

c. Një Deklaratë që obligoheni që të punësoi minimum: 26 punëtorët nga Lista e Autoritetit Kontraktues – duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik dhe deklarata origjinale për stafin shtesë

Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet të paraqes një analize të çmimit të ofruar i cili duhet të mbulojë pagat, obligimet tjera ligjore dhe shpenzimet e parapara për realizimin e shërbimeve dhe është i obliguar që të respektoj Ligjin e punës 03/L-212 MPMS 09/18 dhe Ligjit i ATK-së.

Dëshmia 5: Operatori Ekonomik duhet të paraqes një Analize financiare të detajuar me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar për ofertën e dorëzuar duke përfshirë shpenzimet e materialit, pagat dhe kontributet, pushimet, kujdestarit, festat uniformat, TVSh-ja etj., mos kalkulimi i analizës financiare sipas specifikimit teknik e bën ofertën të pa përgjegjshme“

Për si më lartë, kompania jonë ka bërë një kalkulim të kërkesave elementare bazuar në kërkesat e paraqitura në DT dhe ligjeve në fuqi ka arritur në një përfundim se Buxheti/Vlera e parashikuar nga Ju nuk i plotëson as kërkesat minimale ligjore, shih në grafikë:

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Lidhur me Kërkesën tuaj për Rishqyrtim, në të cilën pretendoni se Autoriteti Kontraktues është në kundërshtim me nenin 17 të LPP-së për shkak të vlerës së parashikuar të kontratës, pas shqyrtimit të detajuar ju njoftojmë si vijon:

Vlera e parashikuar e kontratës përcaktohet nga Autoriteti Kontraktues në bazë të buxhetit të miratuar dhe nevojave të planifikimit të shërbimeve, siç parashihet në nenin 17 të LPP-së. Ky vlerësim nuk ka për qëllim të kufizojë konkurrencën, por të shërbejë si bazë orientuese për planifikimin financiar.

Operatorët ekonomikë janë të lirë të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet teknike të dosjes së tenderit, pavarësisht nëse çmimi i ofertës është më i ulët ose më i lartë se vlera e parashikuar. Sipas LPP-së është përcaktuar $\pm 30\%$ për lot ose pozicion ç'është kontratë kornizë.

Neni 17 i LPP-së thotë se Vlera e parashikuar e kontratës përcaktohet nga AK në përputhje me nevojat dhe buxhetin e planifikuar, jo nga operatorët ekonomikë.

OE mund të vendosë të paraqesë ofertë ose të mos marrë pjesë, por nuk mund ta detyrojë AK-në të ndryshojë buxhetin.

Çmimi i ofertës mund të jetë edhe më i lartë se VPK; AK është i detyruar të marrë parasysh ofertat e përgjegjshme dhe të vlefshme, edhe nëse tejkalojnë buxhetin, duke ndjekur procedurën ligjore për shtim fondesh ose anulim.

Pretendimi juaj për shkelje nuk qëndron, por është mospajtim komercial nga ana juaj.

Prandaj, nuk është evidentuar asnjë shkelje e dispozitave ligjore nga Autoriteti Kontraktues dhe kërkesa juaj për rishqyrtim konsiderohet e pabazuar dhe refuzohet.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>